



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRI

U R D H Ë R

Nr. 92 , datë 17. 05. 2019

PËR

NGRITJEN E GRUPIT TË PUNËS DHE CAKTIMIN E PERSONIT PËRGJEGJËS PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË SHOIPTARËVE OË VUAJNË HEQJEN E LIRISË JASHTË VENDIT , TË DREJTAVE TË MIGRANTËVE NËPËRMJET INFORMIMIT MBI MUNDËSITË E NDRYSHME PËR TË APELUAR NDAJ SHKELJEVE TË TË DREJTAVE TË TYRE, NË STRUKTURAT E VENDEVE PRITËSE SI DHE NË ATO NDËRKOMBËTARE

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, dhe të pikës 1, të nenit 12, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”,

U R D H Ë R O J:

1. Ngritjen e grupit të punës dhe caktimin e personit përgjegjës për zbatimin e masës 24, dhe 44 të planit të veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën, miratuar me vendimin nr.259, datë 9.5.2018, të Këshillit të Ministrave.
2. Grupi i punës do të kryesohet nga zëvendësministri i Drejtësisë, znj. Fjoralba Caka si person përgjegjës për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve që vuajnë heqjen e lirisë jashtë vendit, të drejtave të migrantëve, nëpërmjet informimit mbi mundësitë e ndryshme për të apeluar ndaj shkeljeve të të drejtave të tyre, në strukturat e vendeve pritëse si dhe në ato ndërkombëtare dhe në përbërje të ketë:
 - a) një përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë;
 - b) një përfaqësues të caktuar nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme;
 - c) një përfaqësues të caktuar nga ministri i Shtetit për Diasporën;
3. Grupi i punës është përgjegjës në koordinimin e punëve ndërinstitucionale për mbledhjen e informacionit të plotë, për ndjekjen dhe trajtimin sipas legjislacionit në



vendet pritëse, të shtetasve shqiptarë të cilët vuajnë heqjen e lirisë në burgje jashtë vendit.

4. Zëvendësministri i Drejtësisë, me qëllim përmbushjen e kësaj detyre bashkëpunon me ministrinë përgjegjëse për politikën e jashtme, Avokatin e Popullit apo organizma të shoqërisë civile, me qëllim informimin mbi mundësitë e ndryshme për të apeluar ndaj shkeljeve të të drejtave të migrantëve, në strukturat e vendeve pritëse si dhe në ato ndërkombëtare, të cilat merren me mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut si dhe mbrojtjen e të drejtave të migrantëve.
5. Për realizimin dhe ecurinë e procesit, grupi i punës raporton, me shkrim çdo 3 muaj në mbledhjen e radhës së Komitetit Shtetëror të Diasporës.
6. Institucionet e ngarkuara për zbatimin e këtij urdhri caktojnë përfaqësuesit e tyre në grupin e punës brenda 5 (pesë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri.
7. Ngarkohet Ministria e Drejtësisë, ministri i Shtetit për Diasporën dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA